



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE**

UDHËZIM PLOTËSUES

10889/3

10/2 13
Nr. , Datë /07/2017

13717

“PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT VENDOR”

Në përputhje me ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të Udhëzimit nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, ministri i Financave,

UDHËZON:

I. Të përgjithshme

Ky udhëzim përmban:

- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2018-2020.
- Afatet për përgatitjen e kërkesave për rishikimin e shpenzimeve sipas programit buxhetor afatmesëm.

II. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2018-2020

- Tavanet Përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, të miratuar nga Këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore do të merren në konsiderate për hartimin e buxhetit të vitit 2018.
- Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore do të mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, si dhe në ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Sipas përcaktimit të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore, duke filluar nga viti 2018 njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë 25 për qind të të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura, si dhe 2 për qind të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
- Transferta e pakushtëzuar për vitin 2018, do të jetë afërsisht 5 për qind më e madhe se transferata e pakushtëzuar e buxhetit të vitit 2017.
- Transferta specifike për vitin 2018, do të jetë në të njëjtin nivel financimi si transferata specifike e vitit 2017.
- Formula, kriteret dhe koeficientet e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2018 do jenë ato të vitit 2017.

- Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës specifike për vitet 2018-2020, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2017. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/specifike do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse të saj.
- Kuadri ekonomik 2018-2020, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të PBA-së.

III. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrit të Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
- Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.
- Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë.
- Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor.

IV. Mbështetja Këshillimore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2018-2020, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore adresat e e-mailit: Fran.Brahimi@financa.gov.al, Elidona.Durmishi@financa.gov.al.

HELGA VUKAJ

MINISTËR